



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC



**UDHËZUES I SHKURTËR
PËR FORMIMIN E KOMITETEVE
SHKOLLORE PËR TË DREJTAT E
FËMIJËS**

PRISHTINË, JANAR 2005



PËRMBAJTJA

Përmbajtja e akronimeve – shkurtesave.....	4
1. Qëllimet dhe detyrat e Komiteteve Shkollore për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijës.....	5
1.1. Qëllimi.....	5
1.2. Detyrat.....	5
2. Themeli dhe formimi i Komiteteve Shkollore për mbrojtjen e të Drejtave të fëmijës.....	6
3. Planifikimi i veprimtarisë së Komiteteve Shkollore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.....	7
4. Ditët dhe datat kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me të Drejta e Njeriut.....	9

Përmbajtja e AKRONIMEVE – SHKURTESAVE
 BNSH- Bashkësia e Nxënësve të Shkollës
 DF- Drejtat e Fëmijës
 F – Fëmijë
 KBNSH – Kuvendi i Bashkësisë së Nxënësve të Shkollës
 KEC - Kosova Education Center
 KMDF – Këshilltarët për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës
 KNDF – Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës
 KSHMDF – Komiteti Shkollor për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës
 KV – Kutia e të Vërtetës
 MASHT – Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
 M- Mësimdhënia
 PSH – Parlamenti Shkollor
 PV – Plani i Veprimit
 PVKSHMDF – Plani i Veprimit i Komitetit Shkollor për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës

PASQYRA E TABELAVE, SKICAVE DHE E FOTOGRAFIVE

T.3.1. Plani orientues- veprues i KSHMDF.....	6
Sk.3.1. Plani i veprimit i KSHMDF promotor ndryshmesh në shkollë dhe në shoqëri.....	9
F.3.1. Vizatim i një fëmije (anonim) në temën: Të drejtat e Fëmijës	9



1. Qëllimi dhe detyrat e Komiteteve Shkollore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës

1.1. Qëllimi

Me qëllim të promovimit dhe të fuqizimit të të drejtave të fëmijës nëpërmjet procesit të edukimit dhe të arsimimit me projektin “Edukimi për të drejtate fëmijës” është parrapare themelimi Komiteteteve Shkollore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës – KSHMDF

Qëllimi kryesor i KSHMDF është mbrojtja, respektimi dhe fuqizimi i të drejtave të fëmijës në shkollat e Kosovës.

Punën e KSHMDF e ndihmojnë, koordinojnë dhe monitorojnë Këshilltarët për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës të certifikuar nga KEC në bazë të programit të akredituar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe e Teknologjisë – MASHT.

1.2. Detyrat

Detyrat e KSHMDF janë:

- ✚ Planifikimi i aktiviteteve lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijës në shkollë
- ✚ Organizimi i tryezave, tribunave, debateve në temën të drejtat e fëmijës në shkollë
- ✚ Organizimi i eskpozitave
- ✚ Shënimi i përvejtoreve të datave që lidhen me të drejtat e njeriut dhe fëmijës¹
- ✚ Organizimi i hartimeve me shkrim në temat e ndryshme që lidhen me të drejtat e njeriut dhe të fëmijës
- ✚ Organizimi i ligjëratave në temat e ndryshme që lidhen me të drejtat e fëmijës dhe njeriut (p.sh. mbrojtja nga sida; droga dhe shëndeti; dëmët nga alkooli dhe duhani; ushqimi, ujë dhe shëndeti mbrojtja e ambientit ;metodika e punës intelektuale);
- ✚ Përgatitja e raporteve dhe informatorëve për gjendjen e të drejtave të të fëmijës dhe të njerëzve në shkollë
- ✚ Organizimi i studimeve të vogëla për gjendjen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës
- ✚ Raportimet mujore nga kutija e të vërtetës

2. Themelimi dhe formimi i Komiteteve për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës

Secila shkollë e Kosovës e përpos shumë pikave të përbashkëta i kanë edhe specifikat e veta të cilat secilën shkollë e bëjnë su generis të veçantë. Për këtë arsye janë ekzistojnë disa modalitete të mundshme për formimin e Komiteteve Shkollore.

1. Modaliteti i parë: KSHMDF është oragn pavarurur i përfaqësuesëve të klasave të një shkolle
2. Modaliteti i dytë: KSHMDF është organ i bashkësisë së nxënësve të shkollës
3. Modaliteti i tretë: KSHMDF është organ i Parlamentit të Shkollës

Sipas modalitetit të parë Komiteti për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës formohet nga përfaqësuesit e klasave të shkollës. Secila klasë përfaqësohet nga tre ose katër nxënës duke u nisur nga klasa e gjashtë e shkollës së ulët të mesme. Kështu, nëse shkolla i ka katër klasët (VI, VII, VIII dhe të IX) prej tri klasave përzgjedhen nga tre përfaqësues, ndërsa nga një klasë përzgjedhen 4 nxënës(zakonisht klasa që ka më shumë paralele dhe nxënës). Sipas këtij modaliteti Komiteti Shkollor për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës i ka 13 anëtarë.

Në kuadër të këtij modaliteti ka edhe nënmodalitete tjera që dalin nga specifika organizative e shkollës. Nëse shkolla është e kombinuar nga shkolla filllore dhe nga tri klasët e shkollës ulët të mesme, KSHMDF formohet nga nxënës duke filluar nga klasa e V – të e shkollës filllore deri në klasën e tetë të shkollës së ulët të mesme për tri klasë përzgjidhen nga tre nxënës për klasë, për një klasë përzgjidhen 4 përfaqësues- zakonisht klasa që ka më shumë paralele dhe nxënës.

¹ Shih shtesën 1.

Nëse shkolla i ka 9 klasë(pesë klasë të shkollës fillore dhe 4 klasë të shkollës së mesme) atëherë përfaqësimi bëhet nga 2 nxënës duke filluar nga klasa e IV të shkollës fillore e deri më klasën e IX me përjashtim të një klase e cila i përzgjedhë tre përfaqësues (klasa që ka më së shumti nxënës dhe paralele). Komiteti edhe në këtë rast i ka 13 anëtarë

Sipas modalitetit të dytë formohet Bashkësia e nxënësve të shkollës - BNSH, në të cilën secila paralele përfaqësohet me nga një nxënës. Kështu formohet Kuvendi I Bashkësisë së Nxënësve të shkollës. Bashkësia e nxënësve të shkollës e zgjedhë Kryesinë e Bashkësisë së Nxënësve të shkollës KBNSH. Kryesia e bashkësisë së nxënësve të shkollës i ka 7 – 9 anëtarë. Në Kuvendin e bashkësisë së nxënësve të shkollës formohet edhe KSHMDF I cili i ka prej 9 – 13 anëtarë. Vendimin për numrin e anëtarëve të KSHMDF e bie KBNSH.

Modeliteti i tretë është në procedurë njësoj si edhe procedura e BNSH, për këtu në vend të Kuvendit të Bashkësisë së Nxënësve të Shkollës e kemi emërtimin e Parlamenti Shkollor. Megjithatë sugjerojmë modelin e dytë, sepse Kuvendi i Bashkësisë së Nxënësve të Shkollës në gjuhën shqipe ka kuptim si edhe Parlamenti Shkollor – PSH. Përzagjedhja e modaliteit bëhet nga shkolla varësisht nga struktura organizative dhe preferencat e nxënësve.

3. Planifikimi i veprimtarisë së KSHMDF

Roli kryesor dhe fundamental i KSHMDF është fuqizimi i të drejtave të fëmijës duke siguruar mbrojtje dhe respektim të lartë të tyre në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës – KNDF dhe standardet të tjera ndërkombëtare. Puna e këtij organi nuk duhet të formalizohet. Përkatësisht ky organ nuk duhet themeluar sa për sy e faqe. Që ky organ të shndërrohet në një levë të fuqishme të promovimit të të drejtave të fëmijës është e domosdoshme një qasje kreative, një përkushtim i fuqishëm, shkallë e lartë e humanizmit dhe të marrëdhënieve të humanizuara. Po ashtu është e domosdoshme që puna të projektohet, planifikohet, të identifikohen nevojat reale të komunitetit arsimor e veçmas të fëmijëve. Për të realizuar këtë rol , KSHMDF duhet të

- ✚ hulumtojë nevojat e fëmijëve të shkollës(përmes bisedave – intervistave, anketimeve, kutisë së vërtetës –KV, analizës dhe të revizionit të gjendjes së drejtave të njeriut në shkollë
- ✚ Planifikim kreativ
- ✚ Raportim sistematik dhe transparencë të lartë

Funksionalizmi i punës së KSHMDF bëhet duke hartuar Planin e Veprimit – PV. PV hartohet për një vit. Për çdo muaj duhet paraparë një mbledhje mujore të rregullt. Për secilën mbledhje duhet përcaktuar së paku një pikë të rendit të ditës. Mbledhjet e KSHMDF mund të organizohen edhe më shpesh varësisht nga nevojat.

Në vazhdim e japim edhe një Model të planit të mundshëm të KSHMDF

PLANI VJETOR I KËSHILLIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS

SHKOLLA : _____ në _____

Viti shkollor: _____

Qëllimi: Promovimi dhe fuqizimi i të drejtave të fëmijës duke përmirësuar raportet nxënës-mëmismdhënës; duke krijuar kontakte më funksionale familje - shkollë, duke ndihmuar fëmijët që kanë vështësi në nxënie dhe që i kanë kushtet e vështira materiale teknike, duke ofruar ndihme fëmijëve pa prindër, duke përmirësuar kushtet e punës në shkollë dhe duke rritur shkllallën e vetëdijësisimit për reziqet që vijnë nga droga, sida, alkoholi, duhani.

T.3.1. PLANI ORJENTUES – VEPRUES I KSHMDF

Muajt	Përshkrimi i aktiviteteve	Bartës- realizator	Afati	Realizimi	
				Po	Jo
SHTATOR 2005	1.Shqyrtimi dhe miratimi në shkollë dhe planit të të veprimit për vitin shkollor 2005/2006		5.IX		
	2. Fushatë në shkollë lidhur me : Ditën ndërkombëtare të leximit shkrimit:poster, ligjërata, debate lidhur me clësinë e mësimin në shkollë		1-8.IX		
	3. Fushatë në Bashkësinë lokale lidhur me : Ditën ndërkombëtare të mbështjellësit të ozonit (16 shtator)		5-16.IX		
	4. Fushatë për shënimin e : Ditës ditës ndërkombëtare të paqes (e martja e tretë e shtatorit): ligjërata, posterë, hartime ,ekspozitë figurative: Kombet e Bashkuara etj,		10-20.IX		
	5. Fushatë për : Ditën Ndërkombëtare e njerëzve të moshuar:ligjërata, mbledhja e ndihmave, vizitë shtëpive të pleq posoter, ekspozitë,ligjërata psikologjike, biologjike.Ushqimi dhe mëplakja, ekspozita, poezi, hartime		20.IX-1.X		
TETOR 2005	6. Shënimi i Ditës Botërore të ushqimit:ligjërata,ekspozita, panairë, ndihma nxënësve dhe familjeve të varfëra		1-16.X		
	7.Shënimi i Ditës së Kombeve të Bashkuara: ligjërata, poster, ekspozita, hartime, leterkëmbime		1-24.X		
	8. Ndhmë nxënësve që kanë vështësi në nxënie.		Gjatë vitit		
NËNTOR 2005	9. Fushatë për shënimin e : Ditës së përgjithshme të fëmijëve me rastin e miratimit të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës;Ligjërata, poster, ndihmë fëmijëve me nevoja të veçanta, vizite të jetimoreve, fëmijëve të sëmurë në spitale, apo në shtëpi, vizitë fëmijëve që gjenden në shtëpitë rehabilituese, ekspozita, hartime me shkrime, leterkëmbime etj.		15.X-24.XI		
	10. Fushatë për shënimin e :Ditës ndërkombëtare për luftimin e SIDËS;ligjërata, tribuna, poster, fletëpalosje,ekspozitë e punimeve, tema hartimi, afishe,		1.XI-1.XII		
	11. Aktivitet për shënimin e Festave të Nëntorit		1-28.XII		
DHJETOR 2005	12. Fushatë për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Invalidëve: Vizita shoqatave të invalidëve, mbledhja e ndihmave për fëmijët e invalidëve; organizimi I tribunave, ekspozitave, shkrimi I letrave, hartimeve me shkrim, poezive, ekspozitës së fotografive, etj		15.XI-9.XII		
	13. Fushatë për shënimin e Ditës së Ndërkombëtare të të drejtave të Njeriut: tryeze, tribuna, fletëpalosje, ligjërata, ekspozita,		15.XI-10.XII		
	14.Fushatë për shënimin e :Ditës së UNICEFIT: ekspozitë, fletëpalosje, ribuna, biseda me aktivist të UNICEF-t, leterkëmbime		1.11.XII		
	15.Shënimi i : Ditës së Rinisë në Media: Intervista, tryeza, ekspozita, poster , ligjërata		1-10.XII		
	16.Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Luftës Kundër Korrupsionit		1-9.XII.		
	17.Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Rrefugjatëve: ligjërata, ekspozita, tribuna		5-19.XII		

Muaj	Përshkrimi i aktiviteteve	Bartës- realizator	Afati	Realizimi	
				Po	Jo
JANAR, 2006	18. Analiza e suksesit për gjysmëvjetorin e parë nga këndi I të drejtave të fëmijës		3-15.I.		
	19. Raport për gjendjen e të drejtave të fëmijës në shkollë		15.I.		
	20. Shqyrtimi rekomandimeve për avancimin e të drejtave të fëmijës në shkollë		15-31.I		
	21. Organizimi i debateve, bisedave dhe të diskutimeve nëpër paralele dhe klasë në temën: rekomandimet për avancimin e të drejtave të fëmijës në shkollë		16-31.I		
	22. Fushatë për shënimin e Ditës Ndërkombëtare: për rikujtimin e viktimave të holokaustit: Ligjërata, poster, ekspozitë, hartime		3 -27.I		
SHKURT, 2006	23. Ndhimë nxënësve të varfër		Gjatë muajit		
	24. Ndhimë nënësve që kanë vështirësi në nxënie		Gajtë vitit		
	25. Ndhimë fëmijët që kanë prirje dhe talent të veçantë: diskutime, tebate, ekspozita, tribuna		Gjatë vitit		
MARS 2006	26. Fushatë për shënimin e Ditës së mësuesit: Përgatitja e urimeve, tryeza, tribuna, ekspozita, punime në prozë dhe poezi		25.II-7.III		
	27. Fushatë për shënimin e Ditës ndërkombëtare të Gruas: Ligjërata, tribuna, poster, fletëpalosje, ekspozitë e punimeve, tema hartimi, afishe,		1-8.III		
	28. Fushatë për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Luftës Kundër Diskriminimit Racor: Ligjërata, tryeza, ekspozita, punime në prozë dhe poezi; letra informative		1-21.III		
	29. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Ujit: ligjërata, testimi I shkallës së ndotjes së ujit të pijës në shkollë; tryeza, debate, ekspozita, punime në prozë dhe poezi		1-22.III		
PRILL, 2006	30. Fushatë për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Librit për Fëmijë: Ligjërata, vizita librarive për fëmijë, bisedë me poetë dhe shkrimtarë për fëmijë; ekspozita, tribuna, punime kushtuar fëmijëve në prozë dhe poezi		20.III-2.IV		
	31. Fushatë për shënimin e Ditës së Ndërkombëtare të Shëndetit: Ligjërata tryeza, tribuna, fletëpalosje, ekspozita, punime në prozë dhe poezi		20.III.-7.IV		
MAJ 2006	32. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Shtypit të Lirë: Ligjërata, tribuna, ekspozita, punime në prozë dhe poezi		20.IV-3.V.		
	33. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq: Ligjërata, tryeza, tribuna, ekspozita, organizimi i aksionit vullnetarë për luftimin e tuberkulëzës		20.IV.8.V		
	34. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Familjes: Ligjërata, tribuna, ekspozita, punime në prozë dhe poezi		3-15 .V.		
	35. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Mospirjes së Duhanit: Ligjërata, ekspozita, tryeza, poster, afishe		3-31.V.		
M A I	37. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve: Ligjërata, ekspozita, treyezë, punime të nxënësve në prozë dhe poezi		15.V-1.VI.		

	38. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve Viktima të Agresionit: Ndiuhma, ligjërata, ekspozita, punime të nxënësve në prozë dhe poezi				
QERSHOR, 2006	39. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Mjedisit: Studime për mjedisin: Shkalla e ndotjes së Ujit, Tokës dhe Ajrit; ekspozitë, tryeza, tribuna, punime të nxënësve në prozë dhe poezi, publikime në gazetë murit, a në revistën shkollore		15.IV-5.VI		
	40. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Luftës Kundër Abuzimit dhe të Shitjes Ilegale të Drogës: Poster, ekspozitë, tryeza, ligjërata, punime të nxënësve në prozë dhe poezi		3.V-26.VI.		
GUSHT	41. Raport për realizimin e Planit për vitin shkollor 2005/2006		25.VI-31.VIII		
	43. Shqyrtimi dhe miratimi i planit veprues të punës për vitin shkollor 2006-2007		24.VIII-31.VIII		

Ky plan është orjenues. Shkolla mund ta ndryshojë duke tentuar ta përshtat kushteve dhe të rrethanave specifike të shkollës. Njëherit mund të shtohen aktivitetet të tejsa si psh. raportete nxënës mësimsdhënës në shkollë në dritëne të drejtave të fëmijës; studime rasti që lidhen me nxënësit që kanë vështërsi në nxënie, apo të nxënësve me prirje dhe aftësi të veçanta, mund të planifikohet botimi i revistës shkollës që u dedikohet të drejtave të fëmijës, mund të parashihen aktivitete lobimi, psh, shumëzimi i Konventës së Drejtave të Fëmijës për secilin nxënës dhe organizimi i debateve në klasë dhe paralele në orët e bashkësisë së paraleles; për çdo muaj mund të parashihet një pikë Kutia e të vërtetës – KV

Në hartimin dhe zbatimin e Planit të veprimt – PV, kontribut të madh duhet të japin Këshilltarët për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës – KMDF. Ata marrin pjesë në mbledhjet e KSHMDF, me mësimsdhënësiut e kordinojnë punën. Psh, me mësimsdhënësit e artit figurative përgatisin ekspozita tematike (shiko PV); me mësimsdhënësit e Gjuhës përgatisin punime në prozë dhe poezi; me mësimsdhënësit e Biologjisë dhe me grupin e Ekologëve të ri do të hatrojnë projekte për studimin shkollës së ndotjes së mjedisit, për të cilat më pastaj do shkruajnë punime, do të organizojnë ekspozita e etj.

Duke vepruar në këtë mënyrë KSHMDF do të shëndërohet në faktor të fuqizimit të drejtave të fëmijës në shkollë, rregullimit të raporteve nxënës mësimsdhënëse, avancimit të cilësisë së mësimsdhënies, edukimit për demokraci nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të nxënësve (shih dhe analiz Sk.3.1.



Sk. 3.1. Plani i veprimit i KSHMD promotor ndryshimesh pozitive në shkollë dhe në shoqëri



F.3.1. Vizatim një fëmije(anonim) në temën: të Drejtat e fëmijës

SHTESA: 1. DITËT DHE DATAT E RËNDËSISHME KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE QË LIDHEN ME TË DREJTAT E NJERIUT

DITËT DHE DATAT E RËNDËSISHME KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARË

Pjesë e edukimit për të drejtat e njeriut dhe femijës është edhe shënimi i datave ndërkombëtare. Ky shënim mund të bëhet me aksione të ndërtuara, si në bashkësinë e paraleles, ashtu në bashkësinë e shkollës, në bashkësinë lokale, organet rinore, në media, në organet dhe organizatat qeveritare dhe joqeveritare etj.

Në vazhdim i prezantojmë datatat më të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat lidhen me të Drejtat e Njeriut dhe të fëmijës.

27 janar	Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit të Viktimave të Holokaustit	✓
7 Marsi	- Dita e Mësuesit	✓
8 Marsi	- Dita Ndërkombëtare e Gruas	✓
21 Marsi	- Dita Ndërkombëtare e Luftës Kundër Diskriminimit Racor	✓
22 Marsi	- Dita Botërore për Mbrojtjen e Ujit	✓
2 Prill	- Dita ndërkombëtare e librit për fëmijë	✓
7 Prill	- Dita Ndërkombëtare e Shëndetit	✓
22 Prill	- Dita e Planetit Tokë	✓
3 Maj	- Dita Ndërkombëtare e Shtypit të Lirë	✓
8 Maj	- Dita Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq	✓
15 Maj	- Dita Ndërkombëtare e Familjes	✓
31 Maj	- Dita Botërore e Mospirjes së Duhanit	✓
1 Qershor	- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve	✓
4 Qershor	- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve Viktima të Agresionit	✓
5 Qershor	- Dita Botërore e Mbrojtjes së Mjedisit	✓
26 Qershor	- Dita Ndërkombëtare e Luftës Kundër Abuzimit dhe të Shitjes Ilegale të Drogës	✓
11 Korrik	- Dita Ndërkombëtare e Popullsisë	
12 Gusht	- Dita Ndërkombëtare e të Rinjëve	
8 Shtator	- Dita Ndërkombëtare e Lexim – Shkrimit	✓
16 Shtator	- Dita Ndërkombëtare e Mbrojtjes së Mbështjellesit të Ozonit	✓
E martja e tretë e shtatorit	- Dita Ndërkombëtare e Paqes	✓
1 Tetor	- Dita Ndërkombëtare e Njerëzve të Moshuar	✓
16 Tetor	- Dita Botërore e Ushqimit	✓
24 Tetor	- Dita e Kombeve të Bashkuara	✓
20 Nëntor	- Dita e Përgjithshme e Fëmijëve – Përvjetori i Miratimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijës	✓
1 Dhjetor	- Dita Botërore e Luftës Kundër AIDS-it	✓
3 Dhjetor	- Dita Ndërkombëtare e Invalidëve	✓
9 Dhjetor	- Dita Ndërkombëtare e Luftës Kundër Korrupsionit	✓
10 Dhjetor	- Dita e të Drejtave të njeriut	✓
11 Dhjetor	- Dita e UNICEF-it	✓
E diela e dytë	- Dita e Rinisë në Media	✓
19 Dhjetor	- Dita Ndërkombëtare e Rrefugjatëve	✓
29 Dhjetor	- Dita Ndërkombëtare e Llojlojshmërisë Biologjike	✓

